



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 7776 prot

Tirane, me 27.3/2019

UDHËZIM

Nr. 07 datë 27.3 2019

MBI ZBATIMIN PRAKTIK TË REGJIMIT TË MAGAZINIMIT DOGANOR

Në zbatim të neneve 27 dhe 28, 30 deri 32, 191 deri 199 dhe 210 deri 215, të ligjit Nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neneve 14 deri 19, 21, 22, 31, 32, 539, 545, 631 deri 633 dhe 737, të Vendimit Nr.651 , datë 10.11 2017 të Këshillit të Ministrave “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor;

Mbështetur në pikën 1/b/i, të pjesës VIII/1, të Vendimit nr.921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për personelin e administratës doganore”, i ndryshuar

Me qëllim, zbatimin e saktë të procedurave doganore lidhur me regjimin e magazinimit doganor;

UDHËZOJ:

I. PËRKUFIZIME

1. Për qëllime të këtij Udhëzimi:
 - a) “Magazinë doganore publike e tipit I”, një magazinë doganore publike, ku përgjegjësitë e referuara në pikën 1, të nenit 215, të Kodit, i përkasin mbajtësit të autorizimit dhe mbajtësit të regjimit;
 - b) “Magazinë doganore publike e tipit II”, një magazinë doganore publike, ku përgjegjësitë e referuara në pikën 2, të nenit 215, të Kodit, i përkasin mbajtësit të regjimit;
 - c) “Magazinë doganore publike e tipit III”, një magazinë doganore në të cilën veprojnë autoritetet doganore.
 - d) Magazinë doganore private.

II. APLIKIMI PËR TË PËRFITUAR AUTORIZIM PËR FUNKSIONIM TË AMBIENTEVE TË MAGAZINIMIT DOGANOR

1. Aplikimi dhe autorizimi për funksionim të ambienteve të magazinimit doganor, mbështeten në dispozitat e përgjithshme të përcaktuara në Nënseksionin 1 dhe 2, Seksioni 2, Kreu 2, të Vendimit nr.651, datë 10.11.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar (Kodi Doganor).
2. Aplikimi për autorizim për funksionim e ambienteve të magazinimit për magazinimin doganor të mallrave bëhet pranë Drejtorisë e Përgjithshme të Doganave. Forma e aplikimit mund të jetë në portalin e-albania ose duke paraqitur aplikimin pranë sekretarisë së DPD-së.
3. DPD, maksimumi brenda 30 ditëve nga data e marrjes së aplikimit, verifikon nëse janë përbushur kushtet për pranimin e këtij aplikimi i cili duhet të përbajë:
 - a) Formularin e aplikimit sipas aneksit 8 të Shtojcës C;
 - b) Dokumentacionin ligjor të themelimit të shoqërisë;
 - c) Vërtetim se nuk ka ndjekje penale, të administratorit apo drejtorit të përgjithshëm, vërtetim se shoqëria nuk është në proces likuidimi;
 - ç) Planimetri të ambienteve të planifikuara për regjin e magazinimit doganor të shoqëruara me foto për çdo plan si brënda ashtu edhe jashtë;
 - d) Aktin e kalibrimit të kontenierëve (depozita, sillosa, etj.) në rastet kur do të depozitohen lëngje apo materiale rifuxho;
 - dh) Aktin e pronësisë së këtyre ambienteve ose kontratën e qiramarjes (me një afat që përpunhet minimalisht me planifikimin ekonomik të shoqërisë);
 - e) Një raport ekonomik, minimalisht 2 vjeçar, që tregon nevojën ekonomike të shoqërisë për përdorimin e regjimit të magazinimit doganor, sipas aneksit 2, bashkëngjitur pjesë përbërëse e këtij udhëzimi;
 - ë) Vërtëtim për pagim detyrimesh nga dega e tatimeve ku është e regjistruar shoqëria në lidhje me aktivitetin e saj ekonomik.
 - f) Për qëllime mbikëqyrjeje dhe kontrolli, autoritetet doganore i kërkojnë administratorit të magazines të instalojë/të vendosë sisteme mbikë qyrëse me video-kamera. Administratori i magazines në këto raste siguron transmetimin dhe ruajtjen e pacenuar të imazheve të regjistruara nga sistemet mbikëqyrëse me video-kamera brenda afateve të përcaktuara nga autoritetet doganore.
4. Bazuar në nenin 45, të Kodit Doganor, aplikuesi/mbajtësi i autorizimit, ka të drejtë të ankimojë vendimet e marra nga autoritetet doganore për refuzimin e një aplikimi apo vendimin për anulimin ose revokimin e një autorizimi për funksionim e ambienteve të magazinimit për magazinimin doganor.

III. PROCEDURA QË DO TË NDIQEN NGA ZYRA DOGANORE E VENDOSJES NËN REGJIM

1. Pas pranimit të aplikimit, në bazë të nenit nr.31 te VKM nr.651 date 10.11.2017 "Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor të R.SH" Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i kërkon zyrës doganore të vendosjes nën regjim (pranë së cilës ndodhen ambientet përkatëse) një informacion në lidhje me realizimin e kushteve përfituar magazinën doganore.

2. Me t'u paraqitur kërkesa nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, kryetari i degës së doganës nxjerr urdhrin e vizitës në ambientet e planifikuara për magazinim doganor. (sipas aneksit nr.3).
3. Grupi i punës (2-3 doganier) të ngarkuar për zbatimin e këtij urdhri kryejnë vizitën në këto ambiente jo më vonë se 1 ditë nga dalja e urdhërit.
4. Vizita konsiston në verifikimin dhe plotësimin e të gjithë kërkesave që janë paraqitur në urdhër. Me mbarimin e vizitës aneksi nr.3 fimoset dhe i përcillet kryetarit të degës doganore.
5. Në se nga vizita/kontrolli nuk ka problematika që cenojnë funksionimin korrekt të regjimit dhe mbikqyrjen e tij, kryetari të degës së doganës proçedon me plotësimin e pjesës së mbetur nga aneksi nr.3 që i përket opinionit të kryetarit të degës së doganës, në të kundërt kthehet përgjigje zyrtarisht për arsyet e ndërprerjes së proçedurës së miratimit, mangësitë që duhet të plotësohen.
6. Jo më vone se 30 ditë nga paraqitja e kërkesës, përgatitet informacion, shoqëruar me aneksin 3 dhe i përcillet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe një kopje identike mbahet nga dega doganore.

IV. SHQYRTIMI DHE MIRATIMI

1. Pas paraqitjes së informacionit të degës doganore të vendosjes në regjim, ngarkohet Drejtoria e Proçedurave Doganore, pranë DPD-së, për verifikimin e dokumentacionit.
- Verifikimi konsiston në:

- a) Shqyrtimin e gjithë dokumentacionit.
- b) Shqyrtimin e anekseve 2 dhe 3.
- c) Kërkesë informacioni shtesë brenda DPD për shoqërinë në fjalë.
- ç) Vizitë shtesë në ambjentet e planifikuara për magazinim doganor nëse ka nevojë për saktësime apo riverifikime.
- d) Plotësim të pjesëve përkatëse në aneksin nr.3.
- e) Gjatë proçesit të shqyrtimit nëse ka mangësi njostohet aplikuesi për plotësim të mangësive, dhe gjatë këtij procesi pezullohet afati i shqyrtimit të aplikimit deri në plotësimin e mangësive. Periudha për plotësimin e mangësive zgjat maksimumi për 30 ditë.
- f) Autorizimi përpilohet sipas aneksit 9 të Shtojcës C dhe i paraqitet për miratim sipas shkallës hierarkike vendimarrëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, e cila duhet të shqyrtoje dhe të miratojë autorizimin dhe nëse nuk plotësohen kushtet për miratimin e tij, njostohet zyrtarisht shoqëria për shkaqet e mosaprovvimit të këtij autorizimi.

2. Proçesi i shqyrtimit dhe miratimit të autorizimit duhet të përfundojë brenda një periudhe 30 ditore nga dita e pranimit të aplikimit, pa përfshirë periudhën e pezullimit.
3. Pas aprovvimit të autorizimit dhe paraqitjes së garancisë bankare (që garanton 100% të detyrimeve doganore të mallrave që magazinohen e cila duhet të jetë në përputhje me nenet 84 deri 94, të Ligjit Nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor të Republikës së Shqipërisë"), autorizimi bëhet i vlefshëm në sistemin Asycuda World.

V. MBIKQYRJA E AUTORIZIMIT

1. Autorizimi, për një periudhë 1 vjecare, mbikqyret rreptësish nga dega doganore e vendosjes nën regjim, për të parë nëse përbushen detyrimet qe rrjedhin nga ky autorizim, si dhe justifikimin ekonomik të këtij regjimi.
2. Para mbarimit të këtij afati dega e doganës e vendosjes nën regjim dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave një raport mbi vazhdueshmërinë e këtij rregjimi, raporti duhet të përpilohet sipas modelit të aneksit nr.4 dhe duhet të jetë i miratuar nga kryetari i degës doganore.
3. Për çdo ndryshim në autorizim [vendodhjen(pika 1,5,19 e autorizimit), emrit të shoqërisë (pika 1 e autorizimit), kapacitetet (pika 19 e autorizimit), artikujt/mallrat(pika 7 e autorizimit), shtesë së degës doganore te futjes nen regjim (pika 11/a te autorizimit)] përvëç garancisë doganore, ndiqet e njëjtë procedurë sikur të ishte autorizim i ri (me përjashtim të dokumentacionit të parashikuar në pjesës I deri XII).

VI. DETYRIMET E ADMINISTRUESIT TË REGJIMIT TË MAGAZINIMIT DOGANOR

1. Plotësimi i regjistrat të magazinimit doganor standart sipas modelit të aneksit 5 dhe 5/1 te cilin duhet ta sekretoje në degën doganore mbikqyrëse. Mosplotësimi i këtij regjistri apo plotësimi me mangësi konsiderohet shkelje dhe trajtohet sipas penaliteteve të parashikuara nga Kodi Doganor, regjistri elektronik nuk mund ta zëvendësoje plotësimin e regjistrat tip. Në rastet kur është autorizuar edhe depozitimi i mallrave shqiptare në të njejtat ambjente detyrimisht duhet të jetë plotesuar libri i inventarit sipas aneksit nr.6. Në çdo rast gjëndja fizike duhet të përputhet me gjëndjen sipas regjistrat.
2. Dorëzimi zyrtar brenda çdo date 5 të muajit pasardhës i gjendjes së stokut në degën e doganës e vendosjes nën regjim.
3. Krijimi i kushteve të kontrollit të regjimit (dokumentar e fizik) në çdo moment kur dega e doganës eshte e interesuar. Moskrijimi i tyre do të konsiderohet refuzim i kontrollit doganor dhe do të penalizohet deri në revokim të autorizimit, në përputhje me përcaktimet e nenit 32 të Kodit Doganor.
4. Në rastet kur mbajtësi i autorizimit për arsyet e ndryshme nuk mund të kryeje aktivitet duhet të kërkojë pezullimin e regjimit pranë DPD. Ky pezullim aprovohet vetëm në rastet kur nga dega mbikqyrëse egziston konfirmimi se gjendja e stokut është 0 (zero) dhe nuk ka asnjë detyrim, në të kundërt do të konsiderohet si rregjim pa efekt ekonomik dhe do të revokohet. Në përputhje me nenet 24 dhe 25 te VKM-se nr.651 date 10.11.2017“Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor.
5. Për mallrat ushqimor ose të tjerë me afat kohor përdorimi (skadence), administratori i regjimit të magazinimit doganor duhet të deklarojne afatin kohor kur skadojnë këto mallra. Në kutinë 49/b të DAV-it do të vendoset afati kohor i përdorimit (skadencës) te mallrave. Ky afat kohor duhet të jetë në përputhje me nenin 13 të ligjit nr.9863 datë 27.01.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar dhe urdhërin nr.250 datë 29.07.2011 të Ministrit te Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrotjes se Konsumatorit “Mbi disa masa për hyrjen në territorin e RSH të produkteve ushqimore” në të cilën citohet “ Për produktet ushqimore të cilat importohen për konsum ne territorin e RSH dhe kane jetëgjatësi deri 3/6/12 muaj, lejohen të hyjnë nërmjet PIK nëse në momentin e hyrjes ka mbetur jo më pak se 1/2 e afatit jetëgjatësisë së tyre të deklaruar në etiketten ose dokumentin shoqëruesh”.
P.sh. Nëse kemi import te mallit “biskota” dhe data e prodhimit eshte 01.01.2019 dhe afai I skadences eshte nje vit(01.01.2020) dhe hyrja(IM7) /dalja mallrave (IM4) nga magazinimi doganor mund të kryhet vetëm ne një nga data e gjashte mujorit të pare.

VII. DETYRIMET DHE PERGJEGJËSITË E DOGANIERIT MBIKQYRËS.

1. Per çdo regjim të magazinimit doganor doganieri mbikqyrës të regjimit duhet të mbaje një dosje ku në përbërje të saj të ketë:
 - Kopjen e autorizimit te miratuar me të gjitha shtesat/ndryshime nëse do të ketë,
 - Deklarimet e gjëndjes së stokut nga ana e administratorit të regjimit të magazinimit doganor (çdo date 5 të muajit pasardhës).
 - Kontrollet dokumentare dhe ato fizike. Kontrollet fizike duhet të jenë të paktën një here në tre muaj.
 - Shkeljet dhe kundravajtjet doganore të zbuluara së bashku me penalitetet përkatëse që janë vënë gjatë kontrolleve të ushtruara.
 - Të verifikojë periudhën kohore të deklarimit të mallrave në kutinë 49/b të DAV-it.
 - Të plotësojë aneksin 7-të ne rastin e ndryshimit të pronësisë se mallrave ne Magazinat Doganore Private.
2. Në rast të revokimit/anullimit të autorizimit te regjimit të magazinimit doganor i gjithë dokumentacioni i dosjes duhet të protokollohet ne arshivën e degës doganore.

VIII. FORMALITETET E VENDOSJES SË MALLRAVE NËN REGJIMIN E MAGAZINËS DOGANORE

1. Paraqitja e mallit

Për të gjitha tipet e magazinave vendosja e mallrave nën regjimin e magazinës doganore kushtëzohet nga paraqitja e mallrave në magazinë dhe depozitimi pranë zyrës së vendosjes nën regjim doganor i dokumentit administrativ të vetëm (DAV) i cili plotësohet si më poshtë;

Kutia 1:

- Nëndarja e parë: IM
- Nëndarja e dytë:
- 7 Hyrja e mallrave në regjimin e magazinimit doganor.

Kutia 37:

A – Nëndarja e majtë:

Kodet që aplikohen në ketë nëndarje janë katër shifrore. Dy shifrat e para tregojnë regjimin e kërkuar dhe bazohen në kodet e nënndarjes së dytë të kutisë 1.

- në rastin e importit:
- 71 Rregjimi i magazinimit doganor për mallra jo-shqiptare
- 72 Rregjimi i magazinimit doganor për mallra shqiptare

Dy shifrat që vijojnë janë vazhdimësi e dy të parave përmendur më lart dhe tregojnë rregjimin doganor të mëparshëm. Për këtë arsyë në nëndarja e majte e kutisë 37 do të ketë 4 shifra me kombinime të ndryshme, të cilat gjënden në sistemin Asycuda World .

B – Nënndarja e djathtë:

Një prej kodeve të miratuarës së zgjeruar në sistemin Asycuda World.

- 7125 Magazinimi doganor pas eksportimit per riparime
- 7151 Magazinim doganor të mallrave të vendosura më pare në RPA
- 7153 Magazinim doganor të mallrave të vendosura më pare në RLP me perjashtim të plotë.
- 7155 Magazinim doganor të mallrave të vendosura më pare në RLP me perjashtim të pjesshëm.
- 7156 Magazinim doganor të mallrave të vendosura më pare në ekspozitë ose panaireve.
- 7171 Transferim të mallrave nga një magazine doganore në një magazine tjeter.
- 7178 Magazinim doganor të mallrave të vendosura më parë në Magazinë të lire.

Kutia 49/a: Shënohet numri i identifikimit të magazinës sipas atij të dhënë në autorizimin e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për miratimin e magazinës doganore. Ky numër përbëhet nga gërma korresponduese e tipit të magazinës dhe numri që individualizon çdo magazinë brënda zyrës së degës doganore të vendosjes nën regjim.

Kutia 49/b: Shenohet periudha kohore e qëndrimit të mallrave në regjimin e magazinimit doganor.

Autoritetet doganore të zyrës doganore të vendosjes nën regjim nuk lejojnë hyrje mallrash në regjim në rast se shuma e detyrimeve doganore nuk mbulohet nga garancia e pranuar.

2. Të dhënat e mallit. (Pergjegjesite e mbajtësit të autorizimit ose të regjimit nen 215 i Kodit)

Administratori i magazinës duhet të regjistroje rregullisht në regjistër të gjitha mallrat që hyjnë e dalin nga magazina. Rregjistri përkates duhet të mbahet në ambientet e magazinës. Regjistri i mallrave do ti vihet në dispozicion mbajtësit të autorizimit ose të regjimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave sipas modelit të përshkruar në Aneksin 5 dhe 5/1 të këtij Udhëzimi. Regjistrimi i mallrave në regjistrin e magazinimit doganor behet në momentin e vendosjes fizike të tyre në ambientet e përcaktuara të magazinës. Regjistrimi në rregjister duhet të bëhet jo më vonë se lëshimi i deklaratës për mbylljen (përfundimin) e këtij rregjimi, me destinacionin përkatës.

3. Manipulimet e lejuara të mallrave nën regjim.

Mallrat e vendosura nën regjimin e magazinimit doganor mund t'u nënshtrohen trajtimeve të zakonshme, që kanë për qëllim ruajtjen e tyre, përmirësimin e pamjes ose të cilësisë së tyre tregtar apo përgatiqen e tyre për shpërndarje ose rishitje.

Lista e formave të zakonshme të lejueshme të trajtimit në regjimin doganor janë të përcaktuara ne Aneksin 71-03 Shtojcës A të Vendimit Nr.651, datë 10.11.2017 të Këshillit të Ministrave “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”.

Manipulimet e zakonshme:

- Sistemim
- Ajrim
- Ndarje sipas llojit sasise cilësise etj
- Grupim per plotësim të porosive.

Manipulime të autorizuara:

- Amballazhim.
- Riamballazhim në konfeksione të ndryshme tregtare.
- Etiketim duke ruajtur parimet e cilësisë dhe origjinës.
- Seleksionim.

IX. AFATI I QËNDRIMIT TË MALLRAVE NËN RREGJIM.

1. Në bazë të nenit 211 të Kodit Doganor mallrat mund të qëndrojnë në regjimin e magazinës doganore për një afat kohor të pakufizuar.
2. Dega doganore mbikqyrëse e regjimit te magazinimit doganor është autoriteti që mund të përcaktojë një afat kohor për qëndrimin e mallrave nën regjimin e magazinës doganore. Në raste të veçanta, autoritetet doganore mund të vendosin një afat kohor, brenda të cilit duhet të mbyllët regjimi i magazinimit, në veçanti, kur lloji dhe natyra e mallrave, në rast magazinimesh të gjata në kohë, mund të shkaktojnë rrezik për shëndetin e njerëzve, bimëve ose për mjedisin.
3. Për mallrat ushqimor ose të tjerë me afat kohor përdorimi (skadence) në momentin e vendosjes nën regjimin doganor nga ana e personelit doganor që mbikqyr këtë regjim duhet të verifikohet periudha kohore e deklarimit të kryer nga administrator i magazinës dhe më pas të operohet me hedhjen e këtij afati në kutinë 49/b të DAV-it. Në mënyrë që ky afat kohor të regulloje daljen e mallrave nga regjimi i magazinimit doganor.

X. TRANSAKSIONET TREGTARE BRENDÀ REGJIMIT TË MAGAZINIMIT DOGANOR.

1. Regjimi i magazinimit doganor lejon kryerjen e transaksioneve tregtare (shitje brenda regjimit) duke presupozuar që mallrat janë jo shqiptare dhe për tu bërë të tilla duhet tu nënshtrohen rregullave doganore .
2. Të gjitha këto transaksione janë objekt i legjisacionit tatimor shqiptar dhe bëhen konform rregullave të tij.
3. Të gjitha transaksionet do të bëhen me fatura tatimore shitje të miratuara dhe metoda e vlerësimit doganor duhet të jetë në përputhje me nenet 65-71 të Ligjit Nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor të Republikës së Shqipërisë”dhe nenet 148-169 të Vendimit Nr.651 , datë 10.11 2017 të Këshillit të Ministrave “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”.
4. Në rastet e transaksioneve në “*Magazinë doganore private*” do të plotësohet aneksi nr.7 përmundësimin e veprimeve.
5. Aneksi 7 së bashku me dokumentacionin përkatës dërgohet në rrugë elektronike (me email) në adresën e Sektorit të Procedurave dhe Regjimeve Doganore ne Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave përmundësuar kryerjen e veprimit në sistemin asycuda world.

XI. MBYLLJA E REGJIMIT

Në bazë të nenit 195 të Kodit Doganor mbyllja e regjimit konsiston në hedhjen në qarkullim të lire, rieksportimin apo dhënien e një regjimi të posaçëm.

Kutia nr 40 e DAV-it

Në ketë kuti shkruhet numri dhe data e dokumentit (DAV) të futjes të mallit në regjim (nr.R IMP7).

Kutia 37 e DAV-it

Procedurat përkatëse që do të plotësohen në kstinë 37 do të janë ato të sugjeruara nga sistemi automatik të administrimit të veprimeve doganore Asycuda World.

- 3171 Rieksportim pas hyrjes në regjin e magazinimit doganor të mallrave jo shqiptar
- 4071 vendosje në qarkullim të lirë të mallrave më parë të vendosura në regjin e magazinimit doganor.
- 5171 vendosje në RPA të mallrave më parë të vendosura në regjin e magazinimit doganor.
- 5371 vendosje ne RLP me perjashtim të plotë fë mallrave më parë të vendosura në regjin e magazinimit doganor.
- 5571 vendosje ne RLP me perjashtim të pjesshëm të mallrave më parë të vendosura në regjin e magazinimit doganor.
- 5671 vendosje e mallrave në importin e përkohshëm për eksposita/panaire të mallrave më parë të vendosura në regjin e magazinimit doganor.
- 9371 shkatërrimi i mallrave të vendosura më parë në regjin e magazinimit doganor.
- 9471 braktisja e mallrave të vendosura më parë në regjin e magazinimit doganor.
- 9971 sirot natyrore ose teknike e mallrave të vendosura më parë në regjin e magazinimit doganor.

Në rast se në autorizimin e regjimit të magazinimit doganor është miratuar shkalla e humbjes (pika 21) atëherë përllogaritja e saj do të kryet në përputhje me aktet ligjore dhe nën ligjore të cilat normojnë këto humbje.

XII . REVOKIMI, ANULLIMI

1. Vazhdimësia e autorizimit në fuqi do të varet nga përbushja e kushteve të autorizimit.
2. Në rast se Zyra doganore e vendosjes nën regjin konsideron se administruesi i magazinës ka dështuar të plotësoje kushtet e vendosura në autorizim ose që nuk ekziston më një nevoje ekonomike për regjin, atëherë do të propozoje pranë DPD, revokimin ose anulimin e autorizimit.
3. Drejtori i Përgjithshëm në bazë të dhënave të paraqitura dhe argumentimit përkatës, pasi shqyrton rastin në fjale, mund të revokoje ose anuloje autorizimin.
4. Revokimi i autorizimit mund të bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm edhe për shkaqe të tjera të arsyetuara.
5. Anullimi dhe revokimi i autorizimit do të bëhet në përputhje me përcaktimet e nenit 31 dhe 32 të Kodit Doganor.

XIII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

1. Udhëzimi 3 dt 09.02.2006 shfuqizohet.
2. Ngarkohen strukturat doganore për zbatimin me korrektesë të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.



Aplikimi për autorizim për përdorimin e regjimit të Regjimit te Magazinimit Doganor

1. Aplikuesi /numri NIPTJ	E rezervuar për qëllime doganore		
1.a Adresa e-mail			
2. Procedura/Regjimi doganor	3. Lloji i aplikimit	4. Pjesa vazhduese	
		<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	
5. Vendi dhe lloji i llogarive / rregjistrimeve			
6. Periudha kohore e vlefshmërisë së autorizimit			
a	b		
7. Mallrat që do të vendosen nën procedurën doganore			
Kodi i NK	Përshkrimi	Sasia	Vlera
8. Produkte të përpunuara			
Kodi i NK	Përshkrimi	Koeficienti i shfrytëzimit	
9. Detaje të përdorimit të planifikuar			

10. Kushtet ekonomike	
11. Zyra(t) doganore	
a	e vendosjes nën regjim
b	e mbylljes
c	e mbikqyrjes
12. Identifikimi	13. Periudha kohore e shkarkimit/rieksportit (muaj)
14. Procedura të thjeshtuara	
a.	b.
15. Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve	
16. Informacion shtesë	
17. Emri Nënshkrimi Data	

Aplikimi për autorizim për regjin e magazinimit doganor

- Formulari vazhdues -

18. Tipi i magazinës		
19. Ambjentet e magazinimi të mallrave		
20. Afati kohor për depozitim e inventarit të mallrave		
21. Shkalla e humbjes		
22. Mallra të tjera të magazinuara jo nën regjin e magazinimit doganor		
Kodi NK	Përshkrimi	Procedura doganore
23. Format e zakonshme të trajtimit		
24. Zhvendosje të përkohshme. Qëllimi:		
25. Informacion shtesë		
26.		
Emri	Data.....	
Nënshkrimi.....		

Shënimë shpjeguese për formularët e procedurave të posaçme ndryshe nga transiti

Aneksi 2

Raporti Ekonomik i Planifikuar

Nr.	Artikujt e planifikuar per magazinim doghanor	Vlera ne EURO per 2 Vite	Vlera ne EURO per 2 Vite e planifikuar per ricksport
1			
2			
3			
4			
5			
6			
7			

Shperndaria e importeve ne vlera per 2 vitet ne vazhdim (ne euro)

Muajt									
Viti 201									
Viti 201									

Shuma e detyriimeve doganore te pezulluara per dy vitet ne vazhdim (ne leke)

Muajt									
Viti 201									
Viti 201									

Koha mesatare e qendrimit nen regjimin e magazinimit doghanor nga _____ dite deri _____

Shuma mesatare tregtuese e planifikuar e likujditeve qarkulluese qe zevendetson per dorimi i ktej regjimi _____ leke

Aneksi 3

Dega e Doganes _____

Nr. _____ prot

Date ____ / ____ / ____

Ngarkohen për të vizituar ambientet e planifikuara për magazinim doGANOR nga

Shoqëria _____ NIPT _____

1. _____

2. _____

3. _____

Të dhëna të përgjithshme

Adresa e

ambienteve _____

Nr.telefoni _____

nr.fax _____ email _____

Administratori _____

Firma _____

Personi i Autorizuar _____

Firma _____

Konstatimi fizik

Ambiente të hapura _____ m²

Për tu përdorur në rast
riverifikimi

Të përshtatshme

□

□

□

Ambiente të mbyllura _____ m²

Të përshtatshme

□

□

Mundësitë e plumbosjes

Po □ Jo □

Anekxi 3

Ambiente pune për doganën

Të përshtatshme

Të papërshtatëshme

Mundesitë e kontrollit dhe mbikqyrjes së saktë

Po

Jo

Përshtatshmëria e ambientit për manipulimet e këkuara

Po

Jo

Përshtatshmëria e ambientit për ruajturi mall jo

Po

Jo

Shqiptare dhe shqiptarë

Po

Jo

Egziston mundësia për regime të tjera të posacme brenda ambienteve të magazinimit

Po

Jo

Kolë mesatare për distancen nga dega doganore derri ne këto ambiente

_____ min

Të tjera për tu cilësuar

Doganierët

1.	2.	3.
----	----	----

Opinioni i kryetarit të Degës Doganore

Jam dakort

Nuk jam dakort

Kryetari i Degës Doganore

Dt.

Firma vula

Specialisti i ngarkuar për shqyrtim ne DPD

Aneksi 3

Kërkesën tip sipas aneksit 8 (Shtoja C Dispozita Kalintarë)	E saktë <input type="checkbox"/>	E pasaktë <input type="checkbox"/>
Certifikatën e NIPT-it	E saktë <input type="checkbox"/>	E pasaktë <input type="checkbox"/>
Dokumentacioni ligjor i shoqërisë	E saktë <input type="checkbox"/>	E pasaktë <input type="checkbox"/>
Dëshmi penaliteti, vërtëtim se nuk ka ndjekje penale, të administartorit apo deejtorit të përgjithshëm, vërtëtim se shoqëria se shoqëria nuk është në process llikujdimi	E saktë <input type="checkbox"/>	E pasaktë <input type="checkbox"/>
Planimetri i të ambienteve të planifikuara për regjinin e magazinimit dobanor të shoqëruara me foto për cdo plan si brënda ashtu edhe jashtë	E saktë <input type="checkbox"/>	E pasaktë <input type="checkbox"/>
Aktin e kallibrimit të kontenterëve (depozita,silosa etj) në rastet kur do te depozitoohen lengje apo materiale rifuxho	E saktë <input type="checkbox"/>	E pasaktë <input type="checkbox"/>
Aktin e pronësisë së këtyre ambienteve ose kontraten e qiramarjes(me një afat që përpunhet minimalisht me planifikimin ekonomik të shoqërisë)	E saktë <input type="checkbox"/>	E pasaktë <input type="checkbox"/>
Një raport ekonomik minimalisht 2 vjeçar që tregon nevojën ekonomike të shoqërisë për përdorimin e rregjimit të magazinimit dobanor(sipas modelit të aneksit 2)	E saktë <input type="checkbox"/>	E pasaktë <input type="checkbox"/>

Aneksi 3

Një opinion nga dega e tatinave ku është regjistruar shoqëria në lidhje me aktivitetin e saj ekonomik

Vizite suplementare	E saktë <input type="checkbox"/>	E pasaktë <input type="checkbox"/>
	E saktë <input type="checkbox"/>	E pasaktë <input type="checkbox"/>

Të tjera për tu cilësuar

Shqyrtoi Dokumentacionin

Përpiloj autorizimin Po

Jo Datë _____

Aneksi 4

Dega e Doganës _____

Nr. _____ prot datë ____ / ____ / ____

Propozim për kalimin në definitive të autorizimit të magazinës doganore

Nr. _____ datë _____

Në favor të shoqërisë

NIPT

(Përshkrimi i shkurtër i regjimit)

(realizimi i faktorit ekonomik)

Propozoj të kalojë në regjim definitive

Kryetari i Degës Doganore

Aneksi 6

NJËSIA:

HYRJE		DALJE		BALANCA	
DATA	SASIA	DATA	SASIA	DATA	SASIA

Një fletë libri do të shërbeje për inventarin e vetëm 1 (një) artikulli ky inventor do të shprehë vetëm gjëndjen fizike të lëvizjes së mallrave

Sektor i Procedurave dhe Regjimeve Doganore	Firma	Specialisti	Data e shthesës
---	-------	-------------	-----------------

Dega e Doganës		
Nr.	prot	Date
Vula	Dogani i Mbikqyrës	Nr. e Doganës
Vula	Dogani i Mbikqyrës	

Emri i kompanisë së re	NIP	Afati kohor i operacioneve deti me	Nr. i operacioneve	Vula	Administrator i magazinës doganore
------------------------	-----	------------------------------------	--------------------	------	------------------------------------

Numër	Date	Kodi
-------	------	------

KERKESE PËR SHTESE NE LIDHJET E KOMPANIVE PER AUTORIZIMIN E MAGAZINIMIT DOGANOR